



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Arsim

Odeljenje za Obrazovanje

Department for Education



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje

Raport nëntëmuor i punës

(Janar – Qershor) 2024

-IV- Nr. i prot. 187 Më 15.10.2024
Br. prot. Dt. 24
RAHOVEC - ORAHOVAC

Përgjatë nëntë muajve të vitit 2024 në kuadër të DKA-së u realizuan një varg aktivitete, të cilat ishin të parapara të zhvilloheshin në Planin Vjetor të Punës për këtë vit. Këto aktivitete të zhvilluara gjatë kësaj periudhe po i paraqesim të shkruara sipas muajve, siç vijon:

Muaji Janar

- Në fillim të këtij muaji përgatitëm planin përfundimtar (final) të prokurimit për projektet kapitale, për furnizime dhe për mallra dhe shërbime;
- Nisëm përgatitjet e paramasave për dy projekte; projektin e furnizimit të shkollave me mjete konkretizime dhe laboratorike dhe projektin e furnizimit të bibliotekave të shkollave me libra, për të cilat nisëm procedurat e prokurimit sipas planit vjetor të prokurimit.
- Procesi mësimor i vlefshëm për gjysmëvjetorin e parë, përfundoi më 12 janar, 2024 dhe gjysmëvjetori i dytë filloi më 24 janar 2024.
- Në bashkëpunim me DKRS, me pjesëmarrjen e të gjitha shkollave, organizuam dhe mbajtëm Orën e Madhe Letrare në kuadër të manifestimeve "Flaka e Janarit".
- Më 31 janar 2024 u mbajt trajnimi i fundit i mentorëve të 25 SHFMU-ve nga organizata Kosova Makers League, me ç'rast u bë edhe pranimi i 100 robotëve edukativ (nga 4 për secilën nga 25 shkollat), të cilët u financuan nga komuna jonë.

Muaji Shkurt

- Procesi mësimor i gjysmëvjetorit të dytë vazhdoi të mbahet rregullisht në të gjitha shkollat.
- Nga Policia e Komunitetit kanë filluar të mbahen ligjëratat nëpër shkolla, me temë :Pasojat e përdorimit të narkotikëve".
- Organizuam dhe mbajtëm Garën Komunale të Olimpiadës së Fizikës, në të cilën morën pjesë nxënësit më të mirë të klasave 9, 10, 11, 12.

- Në shkollat e reja në ndërtim, në Xërxë dhe Ratkoc, kanë vazhduar punimet. Në Xërxë ka vazhduar ndërtimi i mureve të brendshme, ndërsa në Ratkoc ka vazhduar puna në montimin e xhamave të dritareve.
- Organizuam aktivitete me nxënës në nderim të 17 shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Kosovës, siç ishin vizitat monumenteve kulturo-historike dhe në vendlënet e dëshmorëve e gjithashtu edhe programe festive në shkolla dhe në programin qendror festiv.
- Më 24 shkurt, 4 nxënësit fitues të Garës Komunale në Fizikë i dërguam në Prishtinë për të marrë pjesë në Garën Shtetërore. Nga 4 nxënësit fitues të Garës Komunale në Fizikë që morën pjesë në Garën Shtetërore, dy prej tyre treguan sukses të lakmueshëm.
- Në kuadër të projektit të riparimeve në shkolla, është punuar në sallën e edukatës fizike të Shfmu “Bekim Sylka”.

Mars

- Në Gexhë kemi përruar projektin e efijencës së energjisë, ndërsa në Çiflak filluan punimet në rregullimin e fushës sportive në oborrin e shkollës.
- Në kuadër të projektit për rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të brendshme është punuar në rregullimin e nyjeve sanitare në objektet e shkollave në Drenoc, Senoc dhe në objektin e IAAP “Selajdin Mullaabazi-Mici”.
- Kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën Profesionale të Informaticientëve të Kosovës (SHPIK) për fillimin e zbatimit të Projektit të Kodimit në Fushën e Teknologjisë Informative.
- Është lidhur kontrata për projektin e furnizimit të shkollave me mjete konkretizimi dhe laboratorike .
- Në shkollat e reja në ndërtim, në Xërxë dhe Ratkoc, kanë vazhduar punimet.
- Ka filluar furnizimi me inventar i 3 çerdheve të reja. Fillimisht, furnizime u bënë në Çerdhen për Fëmijë në Krushë të Madhe dhe më pas vazhdoi furnizimi për Çerdhen e Fëmijëve në Ratkoc.
- Më 31 mars u përrua fusha e re sportive në oborrin e SHFMU “31 MARS” në fshatin Guri i Kuq.

Prill

- Në shkollat e reja në ndërtim, në Xërxë dhe Ratkoc, kanë vazhduar punimet.
- Në kuadër të projektit të riparimeve në shkolla, është punuar në sallën e edukatës fizike të Shfmu “Bekim Sylka” dhe në sallën për aktivitete. Ndërkohë ka filluar puna në drenazhimin dhe hapjen e kanaleve të kullimit përreth objektit të SHML “Xhelal Hajda –Toni”;
- Ka vazhduar furnizimi me inventar i 3 çerdheve të reja;
- Përgatitëm planin e shpërndarjes së librave nëpër biblioteka shkollore dhe planin e shpërndarjes së pajisjeve laboratorike dhe mjeteve të konkretizimit nëpër shkolla;
- Pas pushimit pranveror, sipas kalendarit vjetor të MASHTI-t, rifilloi procesi mësimor i vlefshëm për periudhën e dytë të gjysmëvjetorit të dytë dhe gjithashtu, në bashkëpunim me

policinë e komunitetit u mbajtën ligjërata për nxënësit në gjithsej 4 shkolla. Në 2 shkolla të tjera u mbajtën ligjërata edhe nga përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Maj

- Në bashkëpunim me policinë e komunitetit u mbajtën ligjërata vetëdijësuese për nxënësit edhe në shkolla të tjera.
- Kanë vazhduar vizitat sistematike mjekësore për fëmijët (nxënësit e klasave të para dhe të pesta;
- Nga bashkatdhetari ynë Agron Berisha pranuar donacion një sasi të konsiderueshme të pajisjeve të teknologjisë informative dedikuar shkollave të komunës sonë;
- Vazhduam furnizimin me pajisjeve laboratorike dhe mjeteve të konkretizimit nëpër shkolla Mjete konkretizimi dhe laboratorike nga kimia, fizika, matematika, biologjia, gjeografia e historia janë ndarë në gjithsej 8 shkolla;
- Kemi bërë përgatitjet për fillimin e mbajtjes së garave komunale të diturisë, të cilat u mbajtën në fund të këtij muaji;
- Hapëm konkursin për regjistrimin e fëmijëve nëpër cerdhe dhe konkursin për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës;

Muaji Qershor

- Patëm shënimin e 1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, me një manifestim në Qendrën e Kulturës "Mensur Zyberaj" së bashku me DKRS dhe me SHPG "Hareja".
- Filluan së funksionuari 3 çerdhet e reja, në Krushë të Madhe, Xërxë dhe Ratkoc;
- Në shkollat e reja në ndërtim, në Xërxë dhe Ratkoc kanë vazhduar punimet;
- Kemi bërë përgatitjet për fillimin e mbajtjes së garave komunale të diturisë për klasat e pesta në të gjitha shkollat, të cilat u zhvilluan me sukses;
- Në konkursin për regjistrimin e fëmijëve nëpër cerdhe dhe konkursin për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës, ka vazhduar aplikimi;
- Në kuadër të projektit të riparimeve në shkolla, kanë përfunduar punimet në Shfmu "Bekim Sylka", e po ashtu ka përfunduar puna në drenazhimin përreth objektit të SHML "Xhelal Hajda -Toni".

Muaji Korrik

- Në kuadër të projektit të riparimeve në shkolla, kanë vazhduar riparimet e brendshme në dy objekte shkollore, në SHFMU "Gëzim Hamza-Piktori" në qytet dhe në SHFMU "Rudolf Walther", paralelja e ndarë në Dobidol.

- Ndërkohë, ka përfunduar ndërtimi i 2 rrethojave të oborreve të shkollave, në Dobidol dhe rrethojës së oborrit të Shkollës “Tre Dëshmorët” në Vrajakë-Bratotin;
- Në shkollat e reja në ndërtim, në Xërxë dhe Ratkoc, kanë vazhduar punimet. Në Xërxë është punuar në suvatimin e mureve të brendshme, ndërsa në Ratkoc ka përfunduar suvatimi dhe punimet kanë vazhduar në shtrimin e dysHEMEVE me keramika dhe në izolimin e jashtëm të objektit;
- Kanë filluar punimet paraprake për përgatitjen e terrenit dhe rrethimin e punishtes në vendin ku është planifikuar të ndërtohet objekti i ri i Shkollës “Milaim Krasniqi” në Pastasel;
- Përgatitëm raportin e DKA- së për përfundimin e vitit mësimor dhe e dorëzuam në sekretarinë e kuvendit, pasi që ishte edhe njëra nga pikat e rendit të ditës për këtë muaj.
- Ka përfunduar procesi i regjistrimit të nxënësve për afatin e parë në klasat e dhjeta, në të 3 SHML-të dhe në IAAP “Selajdin Mullaabazi-Mici”;
- Shpallëm rezultatet e përfituesve të bursave për studentët dhe nxënësit dhe ndërkohë për 5 ditë me radhë pranuar ankesat e studentëve dhe nxënësve të pakënaqur;

Muaji Gusht

- Në kuadër të projektit të mirëmbajtjes dhe rregullimit të hapësirave të brendshme, janë zhvilluar punime në riparimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e njeve sanitare në objektin e SHML “Ukshin Hoti” në Krushë të Madhe;
- Më në fund, edhe çerdhja për fëmijë në Xërxë u pajis me inventarin e kuzhinës, i cili i mungonte
- Ka përfunduar procesi i shqyrtimit të ankesave të studentëve dhe nxënësve për bursa dhe janë miratuar të gjitha ankesat;
- Në kuadër të projektit të riparimeve në shkolla, kanë vazhduar riparimet e brendshme në SHFMU “Gëzim Hamza-Piktori” në qytet dhe ndërkohë kanë vazhduar riparimet e brendshme në objektin e SHFMU “Skënder Kastrati”, paralelja e ndarë në Gexhë;
- Po ashtu, në kuadër të këtij projekti, ka përfunduar lyerja e mureve të brendshme në të dy objektet e SHFMU “Isa Boletini” në qytet.
- Gjatë këtij muaji punime ka patur edhe në ndërtimin e rrethojës së oborrit të Çerdhes për Fëmijë “TULIPANËT”, të cilat edhe përfunduan me sukses;
- Në datat 19, 20 dhe 21 gusht është zhvilluar procesi i regjistrimit të nxënësve në klasat e dhjeta, në 3 SHML dhe në IAAP;

- Patëm një vizitë verifikuese nga komisioni I MASHTI-t në 3 çerdhet e reja të ndërtuara, të cilat së shpejti edhe zyrtarisht do të themelohen si institucione të reja të edukimit parafillor;
- Përfundoi edhe trajnimi i 3 grupeve të mësimdhënësve dhe edukatoreve, i cili zgjati 6 ditë me radhë dhe u zhvillua në ambientet e SHFMU “Isa Boletini”;
- Zhvilluam një takim me drejtorët e shkollave, kryetarët e KDSH-ve dhe me koordinаторët e cilësisë. Të shtunën, më 31 gusht 2024, u mbajt Provimi i Maturës për maturanët, i vlefshëm për afatin e gushtit, për të gjithë ata maturanë që në qershor nuk e kishin arritur pragun e kalueshmërisë;
- Përfunduam me procesin e planifikimeve të orëve mësimore dhe kuadrit arsimor për vitin e ri shkollor 2024/2025.

Muaji Shtator

- Më 2 shtator 2024 filloi viti i ri shkollor në të gjitha shkollat e komunës sonë, me ç`rast vizituam 2 shkolla dhe po atë ditë përruram projektin e riparimeve të brendshme në objektin e shkollës në Gexhë;
- Përgatitëm informatën e DKA-së për mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal, për përgatitjet që kemi bërë për fillimin e vitit të ri shkollor, e ku sfidë kryesore e kemi theksuar problemin e furnizimit të nxënësve me tekste shkollore;
- Kemi mbajtur një takim me organizatën FARDI dhe me drejtorët e shkollave për organizimin e garave komunale për çmimin “Xhevdet Bajraj”. Ndërkohë të enjten realizuam dhe një takim me Organizatën YMCA për organizimin e disa punëtorive me nxënësit e shkollave të mesme të larta;
- Në kuadër të projektit të riparimeve në shkolla, janë kryer punime në rregullimin e furnizimit me rrymë për pajisjet e kuzhinës në çerdhen e Xërxës; Këto punime gjatë këtyre ditëve do të ndodhin edhe në 2 çerdhet tjera;
- Gjithashtu, në kuadër të këtij projekti, kemi ndërhyrë në ndarjen e disa klasave në objektin e SHFMU “Faik Konica” dhe në përshtatjen e këtij objekti për të mbajtur mësim në një ndërrim për të gjithë nxënësit e kësaj shkolle;

- Në shkollat e reja në ndërtim, kanë vazhduar punimet. Në Ratkoc po bëhet shtruarja me keramika e dysHEMEVE dhe e hapësirave të brendshme të nyjeve sanitare, ndërkohë që në Xërxë ka vazhduar ndërtimi i Sallës së Edukatës Fizike, përbri objektit të shkollës;
- Gjatë kësaj periudhe vizituam disa shkolla dhe çerdhe për të përcjellur vazhdimësinë e procesit edukativo - arsimor.



Avni Morina
[Signature]
Drejtör i DKA-së